SONY

4-478-288-11(1)

# Stereo sistem kufjesh pa tel

Manual përdorimi

* 4 4 7 8 2 8 8 1 1 * (1)

©2013 Sony Corporation Shtypur në Kinë

MDR-HW300K

**Shqip** **Stereo sistem kufjesh pa tel**

## PARALAJMËRIM

**Për të ulur rrezikun nga zjarri ose shok elektrik, mos ekspozoni këtë aparat në shi ose lagështi.**

Për të ulur rrezikun nga zjarri, mos i mbyllni hapjet për ventilim të aparatit me gazeta, mbulesa, perde etj. Mos ekspozoni aparatin në burime të flakës (për shembull, qiri të ndezur.
Mos ekspozoni bateritë (pakon ose bateritë e instaluara) në ngrohje të tepërt si dritë dielli, zjarr ose tjetër për një kohë të gjatë.

Për të shmangur shok elektrik, mos e hapni shtëpizën. Lejoni që servisimin të bëjnë vetëm teknikët e kualifikuar.

Mos instaloni aparatin në vend të mbyllur, si raft për libra ose vitrinë të integruar.

Meqë kyçësja kryesore përdoret për të larguar njësinë nga priza, lidheni njësinë në prizë të hapur që kapet lehtë. Nëse vëreni ndonjë parregullsi në lidhje me njësinë, largojeni nga priza e murit menjëherë.

Njësia nuk është larguar nga rryma kryesore për derisa është lidhur me prizën e murit, madje edhe nëse njësia është shkyçur tërësisht.

Shtypja e tepër e zërit nga kufjet dhe dëgjueset mund të shkaktojnë dëmtim të dëgjimit.

Pllaka me emrin gjendet në fund të transmetuesit.

Me këtë, Sony Corp., deklaron që kjo pajisje është në përputhje të plotë me kërkesat themelore dhe dispozitat tjera të domosdoshme të Direktivës 1999/5/EC.
Për detaje, shikoni URL më poshtë:
http://www.compliance.sony.de/

Vlefshmëria e CE shenjës është kufizuar vetëm në ato vende ku zbatohet me ligj, kryesisht në vendet e Rajonit Ekonomik Evropian (REE).

**Largimi i pajisjes së vjetër elektrike dhe elektronike (vlejnë për Bashkimin Evropian dhe shtete tjera evropiane me sisteme të ndarë të grumbullimit)**

Ky simbol në produktin ose paketimin tregon që produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbeturinat e shtëpisë. Në vend, duhet të dërgohet në vendin përkatës për grumbullim për riciklim të pajisjes elektrike dhe elektronike. Duke siguruar që produkti largohet mirë, do të ndihmoni në parandalimin e konsekuencave potenciale negative për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, e cila mund të dëmtohet nga trajtimi i gabuar i mbeturinave të këtij produkti.

Materialet për riciklim do të ndihmojnë të mbrohen resurset natyrore, Për informata më të hollësishme mbi e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni zyrën lokale civile, shërbimin për grumbullimin e mbeturinave ose dyqanin në të cilin keni blerë produktin.

**Largimi i pajisjes së vjetër elektrike dhe elektronike (vlejnë për Bashkimin Evropian dhe shtete tjera evropiane me sisteme të ndarë të grumbullimit)**

Ky simbol në bateritë ose në paketimin tregon që bateritë e dhëna me këtë produkt nuk duhet të trajtohet sikur mbeturina shtëpiake.

Për disa bateri, ky simbol mund të përdoret në kombinim me një simbol kimik. Simboli kimik për zhivë (Hg) ose plumb (Pb) mund të shtohen nëse bateria përmban më tepër se 0.0005% zhivë ose 0.004% plumb. Duke siguruar që produkti largohet mirë, do të ndihmoni në parandalimin e konsekuencave potenciale negative për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve e cila mund të dëmtohet nga trajtimi i gabuar i mbeturinave të këtij produkti.

Materialet për riciklim do të ndihmojnë të mbrohen resurset natyrore.

Nëse produktet për shkaqe sigurie, performancë ose integritet të të dhënave kërkojnë lidhje permanente me bateri të inkorporuar, këtë bateri duhet të ndryshohet nga teknik i kualifikuar.

Për të siguruar që bateria do të trajtohet mirë, dorëzoni produktin në fund të jetës në pikë përkatëse për grumbullim për riciklim të pajisjes elektrike dhe elektronike

Për gjitha bateritë tjera, ju lutemi shikoni pjesën për largimin e baterisë nga produkti në mënyrë të sigurt. Dorëzoni baterinë në pikën përkatëse për grumbullim për riciklimin e baterive të vjetra.

Për më tepër informata mbi riciklimin e këtij produkti ose baterisë, ju lutemi kontaktoni zyrën lokale për shërbime, kompaninë për mbeturin ose shitoren në të cilën keni blerë produktin.

**Shënim për konsumatorët: informacionet më poshtë vlejnë vetëm për pajisjes e shitura në vendet që zbatojnë direktivat e BE-së**
Ky produkt është prodhuar nga dhe në emër të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet lidhur me përputhjen e produktit me ligjet e Bashkimit Evropian do të trajtohen nga përfaqësuesi i autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çështje servisimi dhe garancie, ju lutemi drejtohuni në adresën e dhënë në dokumentet e veçanta të garancisë.

## Kontrollimi i pjesëve të dhëna



Transmetues TMR-HW300



Kufje MDR-HW300 (1)



Karrikues (1)



Micro-USB kordon (rreth 50 cm) (1)



Kordon lidhës (rreth 1.5 m) (1)

## Veçori

Ju faleminderit që keni blerë Sony MDR-HW300K sistem stereo kufje pa tel. Para përdorimit të njësisë, ju lutemi lexoni këtë manual në hollësi dhe mbajeni për referencë të ardhmen.
Disa prej veçorive janë:

-**Zë me cilësi të lartë me transmetim digjital të pakompresuar**
2.4 GHz transmetimi digjital parandalon pengesa të intereferncave. Zëri me cilësi të lartë me transmetim digjital pa tel.

-**Zëri i fuqishëm dhe ekspresiv**
Zë i fuqishëm dhe ekspresiv me 40 mm njësi drajveri neodimium.

-**Përshtatje komfore për një periudhë më të gjatë**
Përshtatje komfore për një kohë më të gjatë me mbulesa të veshëve dhe strukturës.

-**Zgjedhja e shpejtë automatike e kanaleve parandalon ndërprerjen e zërin**
Zgjedhja e shpejtë automatike në sistemin e kufjeve siguron sinjal më të mirë. Ky sistem mund të kalojë në kanal të lirë automatikisht pa asnjë ndërprerje të zërit para se të bllokohet sinjali.

-**Funksioni i kontrollit të zërit në kufjet**

-**Karrikim i lehtë me USB portin**
3 orë për karrikim të plotë të baterisë dhe rreth 10 orë të kohës për dëgjim. Mund të përdoret edhe gjatë karrikimit.

-**Opsioni për dizajn me tel**
Kufjet punojnë edhe me tel me kordonin e dhënë lidhës. Mund të kënaqeni me përmbajtjet në telefonin tuaj të mençur, kompjuter ose tablet me opsionin me tel.

-**Dizajn i mbledhjes për ruajtje të lehtë**

## Përdorimi

### 1 Karrikoni kufjet.




### 2 Lidheni me karrikuesin .




### 3 Lidheni A/V komponentin, duke ndjekur lidhjet A ose B më poshtë.

**A Përdorimi i kyçëses së kufjeve të A/V komponentit.**




**B Përdorimi i kyçëses Audio Out (L/R) të A/V komponentit.**

Përdorni adaptor të kyçëses (nuk jepet) mes transmetuesit dhe A/V komponentit.




Nëse zëri është i shtrembëruar duke lidhur transmetuesin me kyçëset e zërit të A/V komponentit, lidheni transmetuesin me kyçësen e kufjeve.

### 4 Vendosni kufjet.

**Para dëgjimit**

Uleni zërin e kufjeve pasi që të ndizet indikatori (On/Standby) për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit të dëgjimit.




### 5 Lëshojeni A/V komponentin.




### Rregulloni zërin.

Kufjet do të lëshojnë një sinjal kur niveli i zërit arrin maksimumin ose minimumin.

Pikë prekëse

### Pas përdorimit

1 Ndaleni A/V komponentin.

2 Shtypeni (On/Standby) butonin në kufjet deri sa indikatori të shkyçet.

**Këshillë**
Kufjet do të shkyçen automatikisht nëse RF transmetimi i sinjalit nga transmetuesi ndalet për 5 minuta.

### Nëse nuk ka sinjal ose sinjali është i dobët për 10 minuta

Nëse transmetuesi nuk gjen asnjë sinjal, indikatori POWER i transmetuesit ndriçon për 10 minuta, pastaj transmetuesit ndalon transmetimin e RF sinjalit automatikisht*. Transmetuesi fillon sërish pasi të pranojë audio sinjalin sërish.

Transmetuesi mund gjithashtu të ndalojë nëse zëri i A/V komponentit të lidhur është i ulët. Në këtë rast, zmadhojeni nivelin e zërit të A/V komponentit në nivel që zëri nuk shtrembërohet dhe pastaj uleni zërin e kufjeve.

*Nëse del sinjal nga A/V komponentit, transmetuesi mund mos të shkyçet edhe nëse vije audio sinjal.

### Përdorimi i njësisë me kordonin lidhës të dhënë

Mund të përdorni njësinë si kufje të rëndomta me tel duke e lidhur kordonin e dhënë lidhës. Mund gjithashtu të karrikoni kufjet gjatë përdorimit me tel. Kujdes që të përdorni vetëm kordonin e dhënë lidhës.

Për të ulur rrezikun nga dëmtimi i dëgjimit, uleni zërin e A/V komponentit para lidhjes.

Kordoni lidhës i dhënë

### Ruajtja e kufjeve

Kontrolloni dy anët e kufjeve para mbledhjes për ruajtje.

### Dëgjimi i zërit nga kufjet dhe TV altoparlantët në kohën e njëjtë

Lidheni transmetuesin me Cable Box/Satellite Box tuaj sesa me TV aparatin.
Disa TV aparate mund të jenë të vendosur të nxjerrin zërin nga kufjet dhe altoparlantët. Për detaje të këtij parametri, shikoni udhëzimet e TV aparatit.

### Shënim mbi lidhjen e komponentit monoaural

Nëse e lidhni transmetuesin drejt me kyçëse të dëgjuesve (mini kyçëse monoaurale) të A/V komponentit, audio sinjali mund mos të del nga kanali i duhur.

## Këshilla mbi karrikimin

### Karrikoni kufjet në fillim

Kufjet përmbajnë bateri ri-karrikues litiumi që duhet të karrikohet para përdorimit për herën e parë.

### Koha e karrikimit dhe përdorimit

| Koha e përaf. e karrikimit | Koha e përaf. e përdorimit[1)] |
|---|---|
| 3 orë[2)] | 10 orë[3)] |

1) në 1 kHz, 0.1 mW + 0.1 mW dalje
2) orë të nevojshme për karrkim të plotë të baterisë të zbrazët.
3) Koha mund të dallojë, varësisht nga temperatura ose kushtet e përdorimit.

### Bateria e mbetur

Për të kontrolluar baterinë e mbetur në kufjet, kyçeni dhe kontrolloni indikatorin . Bateria ende harxhohet kur indikatori ndriçon ngjyrë gjelbër. Karrikoni kufjet nëse indikatori shkyçet, zbehet, ndriçon ose zëri bëhet i shtrembët ose paraqitet zhurmë.

### Karrikimi i kufjeve nga priza e rrymës

Nëse karrikoni kufjet duke i lidhur me prizë rrymë, përdorni USB karrikuesin (nuk jepet). Për më tepër informacione, shikoni udhëzimet për përdorim që vijnë me karrikuesin.

**Shënime**

- -Përdorni vetëm micro-USB kordonin e dhënë. Mos përdorni USB kordonë tjerë.
- -Nëse kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë CHG indikatori mund mos të kyçet menjëherë pas lidhjes me kompjuterin. Në këtë rast, mos e largoni micro-USB kordonin nga kufjet dhe pritni deri sa CHG indikatori të ndriçojë.
- - Karrikoni kufjet në temperaturë ambienti prej 5 °C në 35 °C. Nëse provoni të karrikoni kufjet në temperaturë ambienti jashtë këtij diapazoni, CHG indikatori mund të ndriçojë dhe karrikimi nuk do të bëhet në mënyrë të drejtë.
- -Nëse kompjuteri kalon në modin e hibernimit deri sa është lidhur me kufjet, karrikimi nuk do të përfundojë drejtë. Kontrolloni rregullimin e kompjuterit para se të karrikoni. CHG indikatori do të shkyçet automatikisht kur kompjuteri kalon në hibernacion. Karrikoni kufjet sërish në këtë rast.
- -Lidhni kufjet drejtpërdrejtë me kompjuter. Karrikimi mund mos të kompletohet mirë me lidhje të drejtpërdrejtë siç është me anë të një USB gllavine.
- -Kur jeta e baterisë zvogëlohet në gjysmë, kjo mund të jetë edhe fundi i baterisë. Për ndryshimin e baterisë, konsultoni vendin që keni blerë ose distributorin e Sony.

## Këshilla për nivelin e zërit

- -Nëse lidhni transmetuesin me kyçësen e kufjeve të A/V komponentit, vendosni zërin e A/V komponentit në nivelin më të lartë por jo aq lartë saqë audio sinjali të dridhet.
- -Kur shikoni video, kujdes mos të rritni zërin tepër lartë në skena të qeta. Mund të lëndoni veshë kur zhvillohet ndonjë skenë me zë të lartë.

## Rajoni i transmetimit të RF sinjalit

Rajoni i përafërt i FR sinjalit të transmetimit nga transmetuesi është deri më 30 m.

Zëri mund të ndërpritet nëse kufjet janë jashtë rajonit të transmetimit të RF sinjalit ose kushtet e pranimit janë të keqësuar.

**Shënime**

- -Meqë ky sistem transmeton sinjale në 2.4 GHz, zëri mund të pengohet nëse ka interferenca. Kjo ndodh për shkak të veçorive të radio frekuencës dhe nuk është defekt.
- -Çdo zhurmë që dëgjon nga kufjet mund të dallojë varësisht nga pozita e transmetuesin dhe kushtet e dhomës. Rekomandohet që të vendosni transmetuesin në vend që jep zërin më të qartë.
- - Zëri mund të ndërpritet nëse transmetuesi përdoret me aparate tjera pa tel që përdorin 2.4 GHz frekuencë ose furrë mikrovalë.

## Ndryshimi i mbulesave

Mbulesat mund të ndryshohen. Nëse mbulesat përlyhen ose çahen, ndryshoni sipas mënyrës së dhënë më poshtë. Mbulesat nuk mund t'i blini. Mund të porositni zëvendësime nga shitorja që keni blerë sistemin ose në distributorin më të afërt Sony.

**1** Largoni mbulesat e vjetra duke i nxjerrë jashtë pjesës.



**2** Vendosni mbulesat e reja në pjesën. Siguroni që kufjet të jenë të vendosura në pozitë vertikale.



## Mënjanimi i problemeve

Nëse hasni në probleme gjatë përdorimit të këtij sistemi, përdorni listën më poshtë. Nëse problemet vazhdojnë, konsultoni distributorin më të afërt Sony.

### S'ka zë/Zëri i ulët

- -Kyçni kufjet.
- -Kontrolloni lidhjen e transmetuesin dhe A/V komponentit, karrikuesit dhe prizës së rrymës.
- -Kontrolloni që A/V komponenti është kyçur.
- - Nëse e lidhni transmetuesin e kyçëses së kufjeve të një A/V komponenti, zmadhojeni nivelin e zëri të A/V komponentit deri në nivel ku zëri nuk është i prishur.
- -Siguroni që i keni vendosur kufjet në mënyrë të drejtë.
- -Karrikoni kufjet. Nëse indikatori ende është i shkyçur edhe pas karrikimit, dërgoni kufjet tek distributori i Sony-it.
- -Zmadhojeni zërin e kufjeve.

### Zë i prishur ose i penguar (ndonjëherë me zhurmë)

- -Ndryshoni pozitën e transmetuesit.
- -Lidheni transmetuesin me A/V komponent duke përdorur kyçësen e kufjeve, jo audio out (L/R) kyçëset.
- -Nëse e lidhni transmetuesin me A/V komponentë duke përdorur kyçësen e kufjeve, uleni nivelin e zërit në komponentin e lidhur në nivel ku zëri nuk është i prishur.
- -Karrikoni kufjet. Nëse indikatori ende është i shkyçur edhe pas karrikimit, dërgoni kufjet tek distributori i Sony-it.
- -Kontrolloni nëse ka aparat pa tel që për dor 2.4 GHz frekuencë ose furrë mikrovalë në afërsi.

### Zhurmë e zëshme në prapavijë

- -Kontrolloni nëse ka aparat pa tel që përdor 2.4 GHz frekuencë ose furrë mikrovalë në afërsi.
- -Nëse e lidhni transmetuesin me A/V komponentë duke përdorur kyçësen e kufjeve, uleni nivelin e zërit në komponentin e lidhur në nivel ku zëri nuk është i prishur.
- -Karrikoni kufjet. Nëse indikatori ende është i shkyçur edhe pas karrikimit, dërgoni kufjet tek distributori i Sony-it.

### Zëri ndërpritet

- -Transmetuesi ndalon transmetimin e RF sinjalit automatikisht nëse transmetuesi nuk gjen sinjal ose zëri i A/V komponentit të lidhur është tepër i ultë për 10 minuta. Zmadhojeni nivelin e zërit të A/V komponentit të lidhur deri në nivel ku zëri nuk është prishur.

### Bateria nuk mund të karrikohet/CHG indikatori ndriçon ose nuk ndizet

- -Kontrolloni që kufjet dhe kompjuteri janë lidhur me mirë me micro-USB kordonin e dhënë.
- -Kontrolloni që kompjuteri është kyçur dhe nuk është në standby, sleep ose hibernacion.
- -Kontrolloni që kufjet dhe kompjuteri janë të lidhur drejtpërdrejtë, jo me anë të USB gllavinës.
- -Mund të ndodh problem me USB portin e lidhur të kompjuterit. Lidheni me USB portin tjetër nëse ka tjera.
- -Provoni lidhjen me USB sërish në raste tjera nga ato të theksuar më lartë.

### Sinjal vazhdimisht del dhe kufjet nuk mund të pranojnë audio sinjal nga transmetuesi

- -Lëvizni brenda rajonit të transmetimit të RF sinjalit.
- -Kontrolloni lidhjen e transmetuesin dhe A/V komponentit, karrikuesit dhe prizës së rrymës.
- -Kontrolloni nëse ka aparat pa tel që për dor 2.4 GHz frekuencë ose furrë mikrovalë në afërsi.
- -Ndryshoni pozitën e transmetuesit.
- -Transmetuesi ndalon transmetimin e RF sinjalit automatikisht nëse transmetuesi nuk gjen sinjal ose zëri i A/V komponentit të lidhur është tepër i ultë për 10 minuta. Zmadhojeni nivelin e zërit të A/V komponentit të lidhur deri në nivel ku zëri nuk është prishur.

## Paralajmërime

### Mbi sigurinë

- -Mos e lëshoni, goditni ose ekspozoni kufjet në shok të fuqishëm. Kjo mund të dëmtojë produktin.
- -Mos çmontoni ose provoni të hapni pjesët e sistemit.

### Shënime mbi karrikuesin

- -Vendosni kyçësen e karrikuesit në prizë fortë.
- -Siguroni që të përdorni karrikuesin e dhënë. Përdorimi i karrikuesve tjerë m,e polaritet të ndryshëm ose veçori tjera mund të shkaktojnë që produkti të dështojë.



Kyçëse e unifikuar polare

- -Siguroni që të përdorni vetëm karrikuesin e dhënë. Madje edhe karrikuesit me voltazhin dhe njëjtë dhe polaritetin e njëjtë mund të dëmtojnë produktin për shkak të kapaciteti dhe faktorëve tjerë.

### Mbi burimet e rrymës dhe vendosja

- -Nëse nuk do të përdorni sistemin për kohë të gjatë, largojeni karrikuesin nga priza. Kur të largoni kyçësen, kapeni për karrikuesin. Mos e tërhiqni për kordonin.
- -Mos vendosni sistemin në asnjë prej vendeve më poshtë.
  - -Vend të ekspozuar në dritë direkte dielli, afër ngrohëseve ose vendeve më temperaturë të lartë
  - -Vende me pluhur.
  - -Në sipërfaqe të pasigurt ose pjerrtë.
  - -Vende të ekspozuar në dridhje të mëdha.
  - -Banjë ose vende tjera me lagështi.

### Mbi kufjet

### Veproni me urtësi

Kur niveli i zërit është tepër i lartë, zëri tel jashtë kufjeve. Kujdes mos të rritni zëri shumë që të pengojë personave përreth juve.
Ka tendencë që të rritet zëri në vende me zhurmë. Megjithatë, për arsye sigurie, rekomandohet që të mbahet zëri në nivel që të mund të dëgjoni ende zëra përreth juve.

### Mbi pastrimin

Përdorni leckë të butë pak të zhytur në tretësirë të butë me detergjent, mos përdorni tretës si hollues, benzen ose alkool sepse këto mund të dëmtojnë sipërfaqen.

### Kur produkti prishet

- -Kur produkti prishet, ose ndonjë gjë ka rënë brenda njësisë, menjëherë shkyçeni aparatin dhe konsultoni distributorin më të afërt Sony.
- -Kur të dërgoni sistemin tek distributori Sony, siguron që të merrni edhe kufjet dhe transmetuesin.

## Specifikimet

### Stereo transmetues pa tel (TMR-HW300)

Sistemi i modulimit
GFSK
Frekuenca e valëve të bartësit
2.406 GHz - 2.478 GHz
Distanca e transmetimit
Rreth 30 m më së gjati
Përgjigja e frekuencës
20 Hz - 23,000 Hz
Prishje e zërit 1% ose më pak (1 kHz)
Audio kyçëse Stereo mini kyçëse
Rryma
DC 5 V (nga karrikuesi i dhënë)
Dimensione Rreth 75 mm × 18 mm × 75 mm (w/h/d)
Pesha Rreth 70 g
Harxhimi i matur i rrymës
0.6 W

### Stereo kufjet pa tel (MDR-HW300)

Ndjeshmëria 98 dB/mW
Diapazon i frekuencës për dëgjim
10 Hz – 22,000 Hz
Impedanca 32 Ω at 1 kHz
Kapaciteti i rrymës
1,000 mW (IEC*)
Burimi Baterie e integruar litiumi ri-karrikuese
Pesha Rreth 190 g
Harxhimi i matur i rrymës
2.5 W

* IEC = International Electrotechnical Commission

### Shtojcat e dhëna

Stereo transmetues pa tel TMR-HW300
Stereo kufjet pa tel MDR-HW300
Karrikues (5 V) (1)
Micro-USB kordon (rreth 50 cm) (1)
Kordoni lidhës (rreth 1.5 m) (1)
Udhëzime për përdorim (ky manual) (1)
Fletëgarancia (1)

### Kërkesat sistemore për karrikimin e baterisë me USB

Kompjuter personal me sistemet operative të instaluar më poshtë dhe USB port:
Windows 8 / Windows 8 Pro
Windows 7
Starter / Home Premium / Professional / Ultimate
Windows Vista (Service Pack 2 ose më të ri)
Home Basic / Home Premium / Business / Ultimate
Windows XP (Service Pack 3 ose më të ri)
Home Edition / Professional / Media Center Edition 2004 / Media Center Edition 2005
Mac OS X (version.10.3 ose më të ri)

### Shënimet për markat tregtare

Microsoft, Windows dhe Windows Vista janë marka tregtare të regjistruar ose marka të Microsoft Corporation në shtetet e bashkuara dhe/ose vende tjera.
Macintosh dhe Mac OS janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruar në shtetet e bashkuara dhe/ose vende tjera.
Të gjitha markat tjera tregtare janë marka të regjistruara ose shenja të pronarëve të tyre përkatës. Në këtë manual, ™ dhe ® shenjat nuk janë përdorur.

Dizajni dhe specifikimet janë lënë e ndryshimeve pa paralajmërim paraprak.